

VENDIM
Nr. 427, datë 20.6.2012

**PËR SHPALLJEN E ZONAVE ARKEOLOGJIKE “A” DHE “B” TË QYTETIT TË KRUIJËS
DHE MIRATIMIN E RREGULLORES SË ADMINISTRIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 2 të nenit 30 të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Krujës, sipas hartës dhe koordinatave gjeografike të përcaktuara në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Në pikën 1 të vendimit nr. 6, datë 7.1.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e zonave arkeologjike, brenda qendrave të banuara në Shkodër, Lezhë, Krujë, Durrës, Elbasan, Berat, Vlorë dhe Sarandë”, zonifikimi për qytetin e Krujës, shfuqizohet.
3. Miratimin e rregullores së administrimit të zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Krujës, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe organet e njësisë së qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha